

Sistemi Zgjedhor në Shqipëri për zgjedhjet vendore

Kryetaret/ët e bashkive dhe anëtarët/ët e këshillave vendore për 61 bashkitë zgjidhen drejtpërdrejt për një mandat katërvjeçar. Kryetaret/ët e bashkive zgjidhen me shumicë votash me një raund dhe anëtarët/ët e këshillave vendore zgjidhen nga lista të mbyllura sipas sistemit proporcional.

Njësitë zgjedhore për zgjedhjet vendore janë territoret e bashkive. Numri i këshilltareve/ëve në çdo bashki përcaktohet sipas numrit të popullsisë dhe varion nga 15 deri në 61. Të gjitha partitë dhe koalicionet duhet të paraqesin lista me numrin e kandidateve/ëve të barabartë me numrin e vendeve në këshillin bashkiak përkatës, plus një. Një kandidat/e mund të paraqitet vetëm në një listë dhe renditja në listat e kandidateve/ëve nuk mund të ndryshohet pas regjistrimit. Këshilltarët/ët e zgjedhur marrin mandate sipas renditjes në listën e kandidateve/ëve. Nuk ka asnjë prag si kriter për t'u kualifikuar për ndarjen e vendeve në këshillat vendorë.

Burimi: KQZ/UNWomen. Informacion paraprak mbi proceset zgjedhore në Shqipëri